



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 400/03-26652/24
Kaçanik, 30.10.2024

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 30.10.2024,
pos tjerash,

NJOFTOHET

1. Me Raportin Nëntëmujor Financiar për periudhën: Janar-Shtator-2024, i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048.
2. Në Raportin Financiar si në pikën 1 të kësaj shkrese, janë prezantuar; Pasqyrat e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme të Buxhetit të Komunës së Kaçanikut, për periudhën: 01.01.2024 deri 30.09.2024.
3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese është, Raporti financiar më tekstin e mëtejme, Raporti Nëntëmujor Financiar për periudhën: Janar-Shtator 2024/Lënda: 01Nr. 400/03-26652/24.

Me këtë shkrese njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
Arkivi.





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçaniku

Opština Kacanik - Municipal Kaçanik

I	Data	14.10.24	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.	01	Numri	400/03-266521
			Shtojcë	

RAPORTI NËNTË MUJOR FINANCIAR

Per periudhën: Janar – Shtator

2024

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Për Kuvendin
Komunal

Kryetari i komunës :

Besim Ilazi
Besim Ilazi



Kaçanik, Tetor – 2024

I. Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar – Shtator 2024:

Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar – Shtator 2024 ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë. Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesëve do të prezantohet për 12 (dymbëdhjetë) programet buxhetore:

1. Zyra e Kryetarit,
2. Administrata e Përgjithshme dhe Çështjet Gjinore,
3. Zyra e Kuvendit Komunal,
4. Buxhet dhe Financa,
5. Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm,
6. Shërbimet Publike, Mbrojtje Civile dhe Emergjencat,
7. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural,
8. Planifikimi Urban dhe Mjedisi,
9. Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale,
10. Arsim,
11. Kulturë, Rini dhe Sport,
12. Zyra Lokale për Komunitete.

RAPORTI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR - SHTATOR 2024

TABELA 1: IMPLEMENTIMI I BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR - SHTATOR 2024

TË HYRAT BUXHETORE	Buxheti i miratuar 2024	Buxheti i tanishëm 2024	Shpenzimet 30.09-2024	Shpenzimet 30.09-2023	Progresi në %	Krahasimi 2024/23 në €	Indeksi 2024/2023 (%)
	1	2	3	4	5=3/2	6=3-4	7=3/4
A TOTAL FINANCIMI QEVERITAR	11,034,783.00	11,034,783.00	7,111,060.38	6,854,491.51	64.44	256,568.87	3.74
1 GRANTI I PËRGJITHSHËM	5,130,643.00	5,130,643.00	2,787,509.39	2,397,180.18	54.33	390,329.21	16.28
2 GRANTI I ARSIMIT	4,395,331.00	4,395,331.00	3,468,810.90	3,533,323.88	78.92	(64,512.98)	(1.83)
3 GRANTI I SHËNDETËSISË	1,508,809.00	1,508,809.00	854,740.09	923,987.45	56.65	(69,247.36)	(7.49)
B TOTAL TE HYRAT VETANAKE-PARTICIPIMET DHE DONACIONET	924,200.00	2,314,675.76	508,650.61	201,818.46	21.98	306,832.15	152.03
4 TË HYRAT VETANAKE 2024	924,200.00	924,200.00	170,813.62	105,421.47	18.48	65,392.15	62.03
5 TË HYRAT E BARTURA NGA VITI PARAPRAK	-	1,098,068.10	238,763.06	96,396.99	21.74	142,366.07	-
6 BARTJET E FONDEVE TË VITITER PARAPRAKE: DONATORËT, PARTICIPIMET	-	292,407.66	99,073.93	-	33.88		
TOTALI (A+B)	11,958,983.00	13,349,458.76	7,619,710.99	7,056,309.97	57.08	563,401.02	7.98

Te hyrat e bartura nga viti 2023 ne vitin 2024 deri ne qershorë 2024 867,857.42
 Te hyrat e bartura pas datës 30 qershorë 2024 230,210.68
Totali i HVK të bartura nga viti 2023 ne vitin 2024 1,098,068.10

Bartjet e fondeve nga donatorët nga viti kaluar ne vitin aktual 5,678.30
 Donacionet e pranuar ne 2024-Granti i Performancës 286,729.36
Total pranimet nga donacionet e jashtme 292,407.66

-Buxheti i miratuar i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2024, është caktuar sipas Qarkores Buxhetore nr.2024/01 me kufijtë buxhetor fillestar në shumë prej: **11,958,983.00€**.

-Mjetet e bartura nga vitet paraprake te cilat i janë shtuar buxhetit aktual janë ne shumë totale prej **1,098,068.10** euro. Kështu shuma e buxhetit të tanishëm ka arritur në **13,349,458.76** euro.

- Burimet e rregullta të financimit të Buxhetit Komunal vijnë nga:

1. Granti i përgjithshëm 5,130,643.00 €
2. Granti specifik i arsimit: 4,395,331.00 €
3. Granti specifik për shëndetësi: 1,508,809.00 € dhe
4. Të hyrat vetanake: 924,200.00 €

Struktura e përbërjes së buxhetit të miratuar sipas burimeve të financimit duket kështu:

Grantet Qeveritare: 11,034,783.00 € apo 92.27 % e buxhetit total,
HVK – Projektionet : 924,200.00 € apo 7.73 % e buxhetit total.

-Shpenzimi total per periudhen Janar – Shtator 2024 është në shumë prej 7,619,710.99€ apo 57.08% e planifikimit vjetorë 2024.

II. Raporti i inkasimit të të hyrave vetanake:

Të hyrat vetanake **direkte** të grumbulluara gjatë periudhës raportuese kanë arritur lartësinë e realizimit prej **569,674.48€** që përbëjnë **61.64%** të planifikimit të gjithëmbarshtëm vjetorë në shumë prej **924,200.00€**. Këto të hyra për periudhën Janar-Shtator 2024 janë krijuar sipas burimeve të identifikuara nga të gjitha Drejtoritë bazuar në planifikimet vjetore.

- Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave janë grumbulluar gjithsej: **313,283.85€** apo **55%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Kadastrit janë grumbulluar gjithsej mjete në shumë prej: **125,130.43€** apo **22%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Shuma tjetër e grumbullimit të mjeteve , është realizuar nga këto pesë (6) programe apo drejtori: Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, shuma prej: **24,329.12€**, Administratës së Përgjithshme, shuma prej: **16,763.00€**, Arsimi **28,836.00€**, Drejtoria e Bujqësisë, Plltarisë dhe Zhvillimit Rural, shuma prej: **42,725.13€**, Drejtoria e Shërbimeve Publike, shuma prej: **16,936.95€** dhe Zyra e Inspektoriatit shuma prej **1,670.00€** që së bashku përbëjnë **23%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Krahasuar me inkasimin e realizuar të vitit 2023 të së njëjtës periudhë, nga raporti i realizimit të HVK-së të vitit 2024 del se janë inkasuar mjete prej: **164,225.26 €** më pak se në vitin 2023 nga të hyrat direkte.
- *Rënia në grumbullimin e të hyrave vetanake të Tatimit në Pronë, fillimisht ka ardhur si rezultat i ndryshimeve në Ligjin e Tatimit në pronë, ku sipas ligjit të ri është rritur vlera e zbritjes për secilin tatimpagues për pronën e cilësuar për **banim primarë** nga 15,000.00€ në 30,000.00€, ndryshimet tjera sipas UA nga Qeveria siq është heqja e kushtëzimeve administrative me rastin e regjistrimit të veturave, ndryshimeve tjera kadastrale si psh.shitë-blerja e pronave private nga tatimpaguesve borgjlinjë në tatim prone, poashtu edhe rënia nga taksat për leje ndërtimore të Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit Hapsinorë dhe Mjedisit.*

Të hyrat indirekte të cilat realizohen nga Gjykatat, Policia dhe Agjensioni Pyjor i Kosovës nuk na janë dërguar ende. Këto të hyra meqë realizohen nga këto institucione tjera, nuk perfshihen në planifikim por vetëm si realizim sepse edhe shpenzimi i tyre i takon komunave.

- Ndërsa tabela në vijim paraqet në mënyrë të përgjithshme realizimin e hvk-së për periudhën raportuese, krahasimin e realizimit mes drejtorive dhe viteve:

Emertimi i të hyrave vetanake	Planifikimi Janar-Dhjetor 2024	Realizimi: Janar Shtator 2024	Plani/Realizimi vjetorë (në %)	Realizimi: Janar-Shtator 2023	Krahasoni 2024/2023
Tatimi në pronë	391,545.00	150,884.91	38.54	300,507.98	(149,623.07)
Tatimi në tokë	80,543.00	101,377.44	125.87	85,399.93	15,977.51
Taksa nga regjistrimi i automjeteve	70,000.00	59,075.00	84.39	53,120.00	5,955.00
Taksa nga ushtrimi i veprimtarisë	3,000.00	360.00	12.00	2,530.00	(2,170.00)
Taksa tjera	1,000.00	1,586.50	158.65	290.10	1,296.40
Total: Buxhet dhe Financa	546,088.00	313,283.85	57.37	441,848.01	(128,564.16)
Taksa komunale për leje ndërtimi	190,000.00	26,394.56	13.89	110,955.36	(84,560.80)
Taksa për regjistrimin e trashigimisë	2,000.00	-	-	1,478.92	(1,478.92)
Taksa tjera Administrative	1,000.00	65,686.61	6,568.66	41,035.50	24,651.11
Taksa për çertifikata të pronësisë dhe kopje plani	15,000.00	6,761.00	45.07	9,759.00	
Taksa për leje mjedisore	12,000.00	2,141.67	17.85	11,485.92	
Taksa për legalizimin e objekteve	10,000.00	11,417.59	-	7,696.92	
Shfrytëzimi i pronës publike	16,812.00	80.00	0.48	4,720.26	(4,640.26)
Taksa për matjen e tokës në teren	7,000.00	12,649.00	180.70	10,049.00	2,600.00
Total: Urbanizmi & Kadastrri	253,812.00	125,130.43	49.30	197,180.88	(63,428.87)
Shfrytëzimi publik për tregti të hapur (reklamati)	1,600.00	2,035.20	127.20	2,633.10	(597.90)
Taksa për parking publik	10,000.00	14,901.75	149.02	5,958.50	
Taksa tjera Administrative	100.00	-	-	143.00	(143.00)
Total: Shërbimet Publike dhe Emergjencia	11,700.00	16,936.95	144.76	8,734.60	(740.90)
Taksa e Ndërrimit Destinimit të Tokës	20,000.00	39,567.40	197.84	24,890.77	14,676.63
Taksa për Shfrytëz. e Resurseve nat.	2,000.00	-	-	5,599.98	(5,599.98)
Taksa tjera	2,000.00	3,157.73	157.89	630.00	2,527.73
Total: Bujqësia dhe Pylltaria	24,000.00	42,725.13	178.02	31,120.75	11,604.38
Taksa e çertifikatave të lindjes	15,000.00	13,614.00	90.76	7,233.00	6,381.00
Taksa e çertifikatave të kurorëzimit	5,000.00	1,750.00	35.00	1,666.00	84.00
Taksa e çertifikatave të vdekjes	1,000.00	418.00	41.80	494.00	(76.00)
Taksa e çertifikatave tjera ofiçare	5,000.00	811.00	16.22	9,456.00	(8,645.00)
Taksa tjera Administrative	1,000.00	170.00	17.00	98.00	72.00
Total: Administrata e Përgjithëshme	27,000.00	16,763.00	62.09	18,947.00	(2,184.00)
Gjobat nga inspektorati	5,000.00	1,670.00	33.40	6,170.00	(4,500.00)
Inspektimi higjieniko-sanitarë	200.00	-	-	-	-
Inspektimi i respektimit të planit Urb.	200.00	-	-	-	-
Licencat pranim tekn.lokalit	200.00	-	-	-	-
Total: Të hyrat nga Inspektoriati	5,600.00	1,670.00		6,170.00	(4,500.00)
Taksa për çertifikata mjekësore	10,000.00	7,125.00	71.25	6,304.00	821.00
Participimet në shëndetësi	10,000.00	17,204.12	172.04	10.00	17,194.12
Total: Shëndetësia dhe M.S.	20,000.00	24,329.12	121.65	6,314.00	18,015.12
Participimet	36,000.00	28,836.00	80.10	23,584.50	5,251.50
Total: Arsimi dhe Kultura	36,000.00	28,836.00	80.10	23,584.50	5,251.50
GJITHSEJ TË HYRAT DIREKTE	924,200.00	569,674.48	61.64	733,899.74	(164,225.26)

